

**RREGULLORE  
E PROCEDURAVE TË TRANSFERIMIT TË ASETVE NGA TË  
LICENCUARIT**

**PJESA E PARË  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Autoriteti**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 44, të Ligjit nr.43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neni 29 të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe në zbatim të vendimeve të Bordit të ERE-s për miratimin e licensave në sektorin e energjisë elektrike, gazit natyror dhe në përputhje me Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE, miratuar me vendimin nr 96 date 17.06.2016

**Neni 2  
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë procedurën dhe dokumentat e nevojshme për miratimin e kërkesave të të licensuarve, të cilët paraqesin në ERE kërkesën për:

- a. shitje, dhënie me qera, transferimi, hipotekim, barre ose cfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licensuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhim, transmetim, shpërndarjes së energjisë elektrike
- b. shitje, dhënie me qera, transferimi, hipotekim, barre ose cfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licensuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarive të transmetimit, shpërndarjes dhe operimit të GNL ose depozitave të gazit natyror.

**Neni 3  
Objekti**

Kjo rregullore përcakton procedurat që aplikohen nga ERE si dhe parimet për shqyrtimin e çdo kërkesë për shitje, dhënie me qera, transferimi, hipotekim, barre ose cfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licensuarit sipas Ligjit Nr 43/2015“Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe sipas Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

**RREGULLORE E PROCEDURAVE TË TRANSFERIMIT TË ASETEVE NGA TË LICENCUARIT  
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 119, DATE 21.07.2016 TË BORDIT TË ERE**

**Neni 4**

**Zbatimi**

- a) Kjo rregullore do të zbatohet për të gjithë të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror të cilet kërkojnë të transferojnë asetet e prodhimit transmetimit, ose shpërndarjes sipas përcaktimeve të ligjeve respektive.
- b) Per transferimin e aseteve të të licensuarve me kapacitet te instaluar nen 1 MW, nuk ka nevojë për miratimin e ERE. Per te gjithë te licensuarit e tjere do te kerkohe miratimi i ERE-s per transferim te aseteve kur vlera e asetit qe kerkohe te transferohet eshte me e madhe se 1.50.000.000 leke. ( njeqind e pesedhete milione)
- c) Per transferimin e aseteve të të licensuarve që operojnë një linjë direkte në sektorin e gazit natyror, nuk ka nevojë për miratimin e ERE.
- d) Për transferimin e aseteve me vlerë totale me te vogel se 1.50.000.000 leke. (njeqind e pesedhete milione) apo aseteve që nuk lidhen ngushtësisht me veprimtarinë e licensuar, nuk është i nevojshëm miratimin i ERE.
- e) Per transferimin e aseteve qe realizohet ne kuader te procesit te privatizimeve ne sektorin publik nuk do te aplikohet kjo rregullore.
- f) Kerkesa për transferim biznesi nga të licnesuarit do të rregullohen sipas legjislacionit perkates ne fuqi.
- g) Per HEC-et me fuqi të instaluar me te vogel se 5 MW, kërkohe miratimi i ERE nëse vlera e aseteve që transferohen eshte me e madhe se 50.000.000 leke (pesedhete milione).

**Neni 5**

**Përkufizime**

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë Rregullore do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- a) **“Ligji për energjinë”** do të thotë Ligji Nr 43/2015“Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
- b) **“Ligji për gazin natyror”** do të thotë Ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.
- c) **“Bordi i ERE”** do të thotë organi vendimarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”
- d) **“ERE”** do të thotë autoriteti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin 43/2015 “Për sektortin e Energjisë Elektrike” dhe Ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

**RREGULLORE E PROCEDURAVE TË TRANSFERIMIT TË ASETVE NGA TË LICENCUARIT  
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 119, DATE 21.07.2016 TË BORDIT TË ERE**

- e) **“Liçensë”** është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike, dhe gazit natyror në përputhje me dispozitat e ligjit të energjisë dhe ligjit të gazit natyror.
- f) **I liçensuar** do të thotë një person i cili gëzon të drejtën dhe është i pajisur me liçensë për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike apo gazit natyror në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe Ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”
- g) **Proçedurë** do të thotë tërësia e veprimeve, që kryhen për zbatimin e legjislacionit në fuqi.
- h) **Aset** do të thotë aktivi afatgjatë material që trajtohet nga i liçensuari dhe që i shërben realizimit të një nga aktivitetet e liçencuara në sektorin e energjisë elektrike apo gazit natyror nga ERE.
- i) **Ditë**, do të thotë ditë kalendarike.
- j) **Transferim asetesh** do të thotë çdo veprim me anë të të cilit krijohet një marrëdhënie shitje, dhënie me qira, transferimi, hipotekim, barre ose cfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose asetëve fikse të të liçensuarit që i shërbejnë veprimtarisë së liçensuar.
- k) **Biznes** do të thotë aktiviteti i liçensuar nga ERE për :
  - i. kryerjen e veprimtarisë së prodhim, transmetim, shpërndarjes së energjisë elektrike
  - ii. kryerjen e veprimtarive të transmetimit, shpërndarjes dhe operimit të GNL ose depozitave të gazit natyror.

**PJESA E DYTË  
PROCEDURAT E PARAQITJES SË NJË KËRKESË PËR TRANSFERIM  
ASETESH**

**Neni 6**

**Propozimi për fillimin e një proçedure për transferim asetesh**

Një proçedurë për transferim asetesh fillon me paraqitjen nga një person mbajtës i një liçensë të dhënë nga ERE, të një kërkesë për shitje, dhënie me qira, transferimi, hipotekim, barre ose cfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose asetëve fikse të të liçensuarit që i shërbejnë veprimtarisë së liçensuar.

## **Neni 7**

### **Përmbajtja e kërkesës për transferim**

Çdo i licencuar që paraqet në ERE kërkesën për transferim asetesh duhet të përfshijë në kërkesën e tij, në mënyrën dhe formën e kërkuar nga kjo rregullore, informacionin si më poshtë:

1. Një përshkrim i të licencuarit që përmban informacion mbi:

a) Nje ekstrakt historik të shoqërisë tregëtare të të licencuarit, te leshuar jo me vone se 3 muaj nga data e aplikimit

b) veprimtarinë e licencuar;

c) gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve;

d) një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare;

e) arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit;

f) efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit ;

g) efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifatat e aktivitetit të licencuar;

h) marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të asetëve që kërkohet të transferohen.

i) deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehe gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me pale te tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit;

j-) Nese ka patur, listen e transferimeve te kryera me heret nga I njejti subjekt

2. Me transferimin e asetëve tek personi që I përfiton, në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve të marrëveshjes, licenca e subjektit që ka transferuar asetet, behet e pavlefshme për pjesën e asetëve që transferohen

3. Subjektet konkacionare të licencuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të asetëve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të asetëve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së konkacionit e pjesët që transferojnë tek përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Autoritetit shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të asetëve.

4. Kërkesa, informacioni dhe dokumentacioni i bashkëlidhur kërkesës, duhet të jenë të nënshkruar nga personi ose personat e autorizuar nga shoqëria që kanë kompetencën për përfaqësimin e personit mbajtës licence apo të kandidatit të propozuar.

5. Nëse Bordi i ERE gjykon të nevojshme, mund të kërkojë informacion shtesë nga i licencuari, i cili duhet ta dërgojë informacionin e kërkuar brenda 8 ditëve nga

**RREGULLORE E PROCEDURAVE TË TRANSFERIMIT TË ASETVEVE NGA TË LICENCUARIT  
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 119, DATE 21.07.2016 TË BORDIT TË ERE**

marrja e njoftimit.

6. Pjesë të dokumentacionit që i licencuari kërkon të mos jenë të hapura për publikim, duhet të specifikohen në kërkesën për transferim, së bashku me arsyet e mosbërjes publike të tyre.

**Neni 8**

**Fillimi i Shqyrtimit të kërkesës**

Pasi shqyrton kërkesën e paraqitur, nga subjekti i licensuar në lidhje me transferimin e asetëve, Bordi i ERE shpreh me vendim për fillimin ose jo të procedurave, sipas Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE dhe kësaj rregullore.

**Neni 9**

**Verifikimi i dokumentacionit dhe informacioni shtesë**

1. Bordi i ERE mund të ngarkojë një ose më shumë persona për verifikimin e vërtetësisë së të dhënave të paraqitura nga i licencuari, duke bërë inspektimin në vend.
2. ERE mund të kërkojë nga i licensuari cdo informacion apo dokumentacion shtesë që mund ti shërbejë vendimmarrjes së Bordit për pranimin ose jo të kërkesës së transferimit të asetëve.

**Neni 10**

**Afati i shqyrtimit të kërkesës**

1. Shqyrtimi i kërkesës për transferimin e asetëve, nëse i licensuari ka plotësuar tërësisht informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, do të bëhet brenda 45 ditëve pune nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit.
2. Në rast se dokumentacioni nuk është dërguar konform nenit 7, por është marrë vendim për fillimin e procedurave të shqyrtimit, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni do të fillojë nga dita e paraqitjes së plotë të dokumentacionit të kërkuar nga ERE. Nëse pas marrjes së vendimit informacioni nuk dërgohet brenda 2 muajve, atëherë vendimi për fillimin e procedurave e humbet fuqinë juridike dhe i licencuari do të paraqesë një kërkesë të re në ERE.
3. Në rastin e transferimit të asetëve nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike me kapacitet më të madh se 10 MW, apo nga centralet në sektorin e

**RREGULLORE E PROCEDURAVE TË TRANSFERIMIT TË ASETVEVE NGA TË LICENCUARIT  
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 119, DATE 21.07.2016 TË BORDIT TË ERE**

gazit me vlere me te madhe se 2.000.000.000 leke afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni është 60 ditë.

**Neni 11**

**Parimet për miratimin e kërkesës për transferim**

1. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje, Bordi i ERE do të marrë vendim për miratimin ose refuzimin e kërkesës për transferim, duke e bazuar vendimin e tij në parimet dhe kriteret si më poshtë:

- a) dëmtimi i interesave publike nga transferimi;
- b) gatishmëria e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi për të vazhduar veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit;
- c) ndikimi i transferimit në gjendjen financiare të të licencuarit, si dhe të personit të propozuar për ndryshim, (Mban në të njëjtën nivel, përmirëson apo përkeqëson gjendjen financiare);
- d) ndikimi i transferimit në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të aktivitetit të licencuar;
- e) ndikimi i transferimit në tarifatat e shërbimit për klientët tariforë dhe ndikimi në përfitimet për ata;
- f) ndikimi i transferimit në ekonominë e komunitetit, në rastin e kompanive publike;
- g) mundësia financiare dhe teknike e personit të propozuar për transferim, për të vazhduar operimin e asetëve dhe kryerjen e riparimeve të tyre, nëse janë të nevojshme;
- h) mundësinë e personit të propozuar për transferim për të mbuluar efektin financiar në rritjen e tarifave që mund të shkaktohet nga transferimi i asetëve.

**Neni 12**

**Njoftimi për vendimin**

1. Në përfundim të procedurës për transferim aseti, brenda 5 ditëve pune, ERE do të njoftojë të licencuarin mbi vendimin e Bordit, si dhe do t'i dërgojë atij një kopje të vendimit. Nje kopje e vendimit i shkon edhe Autoritetit Shteteror përgjegjës në rastin e transferimit të asetëve të një subjekti koncensionar.
2. Vendimi i Bordit të ERE për kërkesën për transferim asetesh do të publikohet në Fletoren Zyrtare.

**RREGULLORE E PROCEDURAVE TË TRANSFERIMIT TË ASETVE NGA TË LICENCUARIT  
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 119, DATE 21.07.2016 TË BORDIT TË ERE**

**Neni 13  
Ankimi gjyqësor**

Kundër vendimit të Bordit të ERE për miratimin apo refuzimin e transferimit të asetëve, mund të bëhet ankimi në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.

**PJESA E TRETË  
DISPOZITA TË FUNDIT**

**Neni 14  
Amendamente të rregullores**

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE, në përputhje me “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE”.

**Neni 15  
Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.